



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të paragrafit 13.3 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 24 nëntor 2018,  
Bordi i Federatës miraton këtë:

## **RREGULLORE NR. #02**

### **PËR**

### **TARIFAT PËR ANËTARËSIM NË FEDERATË DHE PËR PJESËMARRJE NË TURNE**

### **VERSIONI 1.2**



## PËRMBAJTJA

1. Qëllimi.....	2
2. Tarifa për anëtarësi në Federatë .....	2
3. Tarifat për pjesëmarrje në turne .....	3
4. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera .....	3

## VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	01.01.2019	Bordi / 29.01.2019	-
1.1	01.01.2020	Bordi / 15.01.2020	2.1. Qartësohet tutje që mbikëqyrësi është përgjegjës për pagesa të anëtarësisë. 2.2.3. Referët do të paguajnë 10 EUR për anëtarësim
1.2	24.03.2022	Bordi/ 23.03.2022	2.5. Federata lëshon kartelë identifikimi për të anëtarësuarit.



## 1. Qëllimi

- 1.1. Përmes kësaj rregulloreje caktohet tarifa e anëtarësisë në Federatë për një vit kalendarik.
- 1.2. Njëkohësisht rregullohen edhe tarifatat për pjesëmarrje në turnetë e Federatës.

## 2. Tarifa për anëtarësi në Federatë

- 2.1. Anëtarësimi në Federatë vlen për një vit kalendarik. Ajo mund të paguhet përmes transferit bankar në llogarinë e Federatës, ose para pjesëmarrjes në turne me para të gatshme tek referi mbikëqyrës i turneut të parë në të cilin tenisti merr pjesë. Referi mbikëqyrës obligohet t'i dorëzojë pagesat e anëtarësisë në Federatë për të gjithë tenistët pjesëmarrës për të cilët është dashur ta mbledh anëtarësinë, në të kundërtën shuma do t'i ndalet nga mëditjet.
- 2.2. Tarifatat vjetore në fuqi nga data 1 janar 2020 janë:
  - 2.2.1. Klubet 50 EUR
  - 2.2.2. Trajnerët 10 EUR
  - 2.2.3. Referët 10 EUR
  - 2.2.4. Tenistët (të gjitha grupmoshat) 5 EUR
- 2.3. Në rast se tenisti (nën 2.2.4) paguan anëtarësinë në nëntor të një viti ajo pagesë do të vlejë edhe për tërë vitin e ardhshëm, përderisa pagesa nuk është pagesë e vonuar për vitin që ikën.
- 2.4. Për tenistët që për herë të parë marrin pjesë në garat e Federatës, krahas pagesës duhet dërguar në email adresën e Federatës edhe kopja (e skanuar) e një dokumenti të identifikimit apo e certifikatës së lindjes.
- 2.5. Federata lëshon kartelë identifikimi për të anëtarësuarit.
- 2.6. Klubet, trajnerët, referët ose tenistët që nuk e paguajnë anëtarësinë, nuk mund të përfitojnë nga përkrahja e Federatës apo të jenë pjesë e aktiviteteve që organizon Federata.



### 3. Tarifat për pjesëmarrje në turne

3.1. Tarifat në fuqi nga data 1 janar 2020 janë:

3.1.1. Grupmoshat ROG	5 EUR
3.1.2. Grupmoshat U12-U18	10 EUR
3.1.3. Kategoria “A”	15 EUR
3.1.4. Kategoritë “35+”	20 EUR

3.2. Pagesa e tarifës do t’i sigurojë lojtarit pjesëmarrje në turne, dhe së paku ujën e pijes nga organizatori.

3.3. Tarifat paraqesin të hyra për organizatorin e turneut.

3.4. Tenisti që nuk është tërhequr nga turneu brenda afatit të caktuar dhe përfundon pjesë e shortit të publikuar, obligohet për pagesë të tarifës për pjesëmarrje.

### 4. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera

4.1. Kjo rregullore hyn në fuqi nga viti kalendarik 2019 e tutje.

4.2. Hyrja e saj në fuqi shfuqizon “Rregulloren për Pagesën e Anëtarësisë për Vitin 2015” të datës 12 prill 2015, si dhe të gjitha rregulloret apo vendimet e tjera të Bordit që janë në kundërshtim me të.

4.3. Interpretimi përfundimtar i kësaj rregulloreje është kompetencë e Bordit.

**Jeton Hadergjonaj**  
Kryetar  
Federata e Tenisit e Kosovës



Prishtinë, 23 mars 2022